



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.231/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevcu kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore Arjeta Sylja, duke vendosur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Drenas, për shkak të Thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatet, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 18.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), me shenjen ZL.Anr.231/2017 e datës 17.10.2017, me të cilën ka kërkuar që ti shqiptohet dënimi me gjobë subjektit politik Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), dega në Drenas, për shkak të thyerjes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatet.

A r s y e t i m

Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese BIRN dhe Internews Kosova (IKS), ka parashtruar ankesë në PZAP më datë 17.10.2017, me të cilën pretendon se, kandidati për kryetar të Kuvendit Komunal të Drenasit, nga radhët e subjektit politik PDK, Ramiz Lladrovci, pretendohet se ka shkelur rregullën zgjedhore 13/2013 neni 5.2, duke përfshirë fëmijë në fushatë zgjedhore të mbajtur me datë 16.10.2017. Më tej ka pretenduar në ankesë se në bazë të fotove të publikuara nga kandidati Ramiz Lladrovci, në faqen e tij të facebook-ut, vërehet prezenca e fëmijëve në fushatë ku në bazë të postimit vërehet se tubimi ka qenë me karakter politik.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur 3 fotografi në lidhje me rastin në fjalë.

Subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), në përgjigjen në ankesë të datës 18.10.2017, ka theksuar se ankesa e organizatës BIRN dhe IKS, është e pabazuar dhe nuk përmban shkelje të Rregullave Zgjedhore, duke theksuar se fotot e marrura nga facebook-u nuk dëshmojnë se është bërë shkelje e nenit 5.2 të Rregullës Zgjedhore 13/2013. Gjithashtu, ka theksuar se pamjet në foto për gjoja pjesëmarrjen e fëmijëve në fushatë në rastin konkret nuk mund të dëshmohet për moshën e tyre.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar

Pretendimet ankimore se në aktivitetet e kandidatit për kryetar të Komunës së Drenasit, nga radhët e subjektit politik PDK, Ramiz Lladrovci, janë përfshirë fëmijë, Paneli gjeti se këto pretendime janë të paqëndrueshme pasi që nga fotografit që gjenden në shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se personat prezent kanë qenë nën moshën 18 vjet.

Andaj, paneli erdhi në përfundim se janë të paqëndrueshme pretendimet se është bërë fushatë zgjedhore me fëmijë nga ana e kandidatit të subjektit politik PDK.

Andaj duke u bazuar në arsyet e dhëna më lartë dhe në kuptim të nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Zl.Anr.231/2017 më datë 18.10.2017.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.